

**STATUTI & AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DM VLORA” SH.P.K.**

**Neni 1
Emërtimi i shoqërisë.**

Sot me datë 15/11/2023 krijohet shoqëria me pergjegjësi të kufizuar e quajtur **“DM VLORA” Sh.p.k.** nga ortaket:

- Genc Deromemaj shqiptar i datëlindjes 29/03/1984 me nr. identifikimi I40329018L me pergjegjësi të plotë juridike për të vepruar;
- Knidi Merkaj shqiptar i datëlindjes 16/03/1997 me nr. identifikimi J70316061R me pergjegjësi të plotë juridike për të vepruar.

Shoqëria është person juridik dhe ushtron veprimitarë në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”.

**Neni 2
Selia e shoqërisë.**

Selia e shoqërisë **“DM VLORA” Sh.p.k.** është Vlorë, Lagjja “15 Tetori”, Rruga “Shefit Zenaj”, Nd.6, H.3/3. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj. Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacioni në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

**Neni 3
Kohëzgjatja e veprimitarës.**

Shoqeria do të ushtrojë aktivitetin tregtar do të jetë subjekt i te drejtës me një afat të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të ortakut të shoqërisë.

**Neni 4
Objekti.**

Objekti i shoqërisë do te jete si vijon:

Ndërtime civile, industriale, turistike, diga, tunele, galeri. Punime mbrojtëse dhe sisteme hidraulike. Ndërtim sillota, kulla ujite prej beton arme. Rikonstrukcion godinash. Ndërtim vepra kullimi ujite. Mirëmbajtje e zhvillim dekor i në mjetëse urbane. Prodhim materiale inerte. Prodhim elementësh të parafabrikuar. Ndërtim rrugësh. Perforcime themeli, punime karpienterie. Pastrim i sipërsfaqeve urbane. Shërbime funerali. Ndërtim vepra arti. Projekte. Në fushën e ndërtimit, zbatimit, projektimit dhe rikonstruksioneve. Prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit. Tregtim me shumicë dhe pakicë inerte dhe materiale te tjera ndërtimi. Ndërtim civile dhe ekonomike, ndërtim rrugore, ndërtim hekurudhore, ndërtim elektrike, ndërtim ura dhe vepra arti, ndërtim detare, ndërtim hidraulike, restaurime, impiante teknologjike, punime topogjeodezike etj. Prodhim, transport dhe shitje të minraleve, hapje galerish, gërmime në sipërsfaqe, punime gjelberimi, etj. Mirëmbajtje rrugësh dhe sinjalistike rrugore. Ndërtim dhe rikonstrukcion i N/stacioneve elektrike, kabinave te transformatoreve,

Konsulencë, projektim, zbatim projektesh në fushën e ndërtimit, administrim, menaxhim objektesh. Ndërtim dhe mirëmbajtje i impianteve teknologjike, termike dhe kondicionimi. Ndërtim dhe mirëmbajtje i impianteve të sinjalistikës ndricuese të trafikut rrugor. Ndërtim dhe mirëmbajjen i impianteve dhe linjave telefonike dhe telekomunikacionit. Ndërtim dhe mirëmbajtje i linjave teknologjike të survejimit dhe monitorimit. Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime rifiniture të muraturesh dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndërtimit, industriale. Prodhim mobiljesh, stolive te çmuara, instrumentave muzikore, produkte metalike, produkteve elektroshëpiake, prodhim monedhash, prodhim energjje elektrike, prodhim gazi, trajtim i mbetjeve urbane grumbullim i mbetjeve të rrezikshme, projekteve të ndryshme në lidhje me energjinë elektrike, keshillim teknik inxhinierik, aktiviteti arkitekturës, pastrim ndërtesash, mirëmbajtje etj.

Neni 5 Kapitali i regjistruar.

Vlera e kapitalit te kontribuar dhe i regjistruar në shoqëri është 200'000 leke (dyqind mijë), numri i kuotave eshte 2 (dy) i zotëruar sipas kontributeve:

- Genc Deromemaj shqiptar i datëlindjes 29/03/1984 me nr. identifikimi I40329018L me 50 kuota në masën 50%;
- Knidi Merkaj shqiptar i datëlindjes 16/03/1997 me nr. identifikimi J70316061R me 50 kuota në masën 50%.

Kapitali i shoqërisë mund të irritet apo të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

Neni 6 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë “DM VLORA” Sh.p.k. e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgiminisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër tëparashikuarme ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet nëshkrim.

Kalimin e kuotave, veçanërisht miratohen në mbledhjen e asamblesë të shoqërise ku të drejtën e parablerjes e kanë ortakët e shoqërisë.

Neni 7 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Të drejtat dhe detyrimet.

- I. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

- b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesvedhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendumë shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tëraporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zgogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikes 1 të këtij nenit, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Vendimet e paregjistruese në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8
Mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një here në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon tëb lejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.



- Dispozitat e pikës 6 të këtij nenit nuk zbatohen nëse blerjet; sipas pikave 4 e 5 të këtij nenit, kryhen në bursë ose janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu. Gjithashtu, këto dispozita nuk zbatohen në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm/asambleja e ortakeve.
- Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

Neni 9
Mënyra e thirrjes.

- Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10
Kërkesa nga ortakët e pakicës.

- Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.
- Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij nenit, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - Të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përbushin kërkësat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - T'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij nenit dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të këtij ligji.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarjen e përfaqësuesit për interesat e tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

Neni 11
Përfaqësiminë asamble.

1. Ortaku mund tē pērfaqēsohet nē asamblenē e pērgjithshme, nē bazē tē njē autorizimi nga njē ortak tjetēr apo nga njē person i tretē.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund tē veprojnë si pērfaqēsues tē ortakëve nē asamblenē e pērgjithshme.
3. Autorizimi mund tē jepet vetēm pēr njē mbledhje tē asamblesë sē pērgjithshme, e cila pērfshin edhe mbledhjet vijuese me tē njëtin rend dite.

Neni 12
Kuromi.

1. Nē rastin e marrjes sē vendimeve, qē kérkojnë njē shumicë tē zakonshme, asambleja e pērgjithshme mund tē marrë vendime tē vlefshme vetēm nēse marrin pjesë ortakët me tē drejtë vote, qē zotërojnë më shumë se 30 pēr qind tē kuotave. Nē rastin kur asambleja e pērgjithshme duhet tē vendosë pēr çështje, tē cilat kérkojnë shumicë tē kualifikuar, sipas nenit 87 tékëtij ligji, ajo mund tē marrë vendime tē vlefshme vetēm nēse ortakët qē zotërojnë më shumë se 'gjysmën e numrit total tē votave janë tē pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve tē pikës 3 tē nenit 88 tē këtij ligji.
2. Nēse asambleja e pērgjithshme nuk mund tē mblidhet pēr shkak tē mungesës sē kuorumi tē përmendor nē pikën 1 tékëtij nenë, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me tē njëtin rend dite.

Neni 13
Marrja e vendimeve.

1. Me pērjashtim tē rasteve kur statuti parashikon një shumicë më tē lartë, asambleja e pērgjithshme vendos me tritë katërtat e votave tē ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet nē pikën 1 tē nenit 86 tē këtij ligji, pēr ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit tē regjistruar, shpërndarje ne fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Me pērjashtim tē rasteve kur parashikohet ndryshe nē këtë ligj ose nē statut, pēr çështjet e tjera tē renditura nē nenin 81 tē këtij ligji, asambleja e pērgjithshme vendos me shumicën e votave tē ortakëve pjesëmarrës.
3. Me pērjashtim tē rasteve kur parashikohet ndryshe nē këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë tē drejtat e tyre, tē parashikuara nē këtë ligj ose nē statut, kushtëzohet nga miratimi iortakut përkates.

Neni 14
E drejta e votës.

1. Me pērjashtim tē rasteve kur parashikohet ndryshe nē statut, qdo kuotë jep tē drejtën e një vote.
2. Statuti mund tēparashikojë pēr ortakët, qē nuk janë tē pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes nē mbledhjen e asamblesë sē pērgjithshme me mjete tē ndryshme komunikimi, pērfshirë



mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi ortakëve.

3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen përmbladhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjeter;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë se përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, përtë marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për tu mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme përtë garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë ekomunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorimtë jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ky ligj apo statuti, përtë marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 15 Përjashtimi nga e drejta e votes.

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprintarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) ç) dhënen osejo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 16 Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë.

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen përmbladhjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Prosesverbalit duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalist, rezultatet e votimit.
3. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi I procesverbalist.
5. Nëse shoqëria ka publikuar njëfaqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalist të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.



Neni 17
Drejtimi dhe administrimit.

Shoqëria tregtare "DM VLORA" Sh.p.k. do të drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të Asamblesë të Shoqërisë. Administratori i shoqërisë për periudhën 5 vjecare duke filluar nga data e sotme do të jetë Faire Merkaj, shqiptare e datëlindjes 19/09/1968 me numer identifikimi G85919062U. Administratori ka të drejtë e të detyrohet të:

- Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politika tregtare të vendosur nga asamblea e përgjithshme e shoqërisë;
- Përfaqesojë shoqërinë tregtare;
- Kujdeset për mbajtjen saktë e të regullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe sëbashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto përparrë asamblesë së përgjithshme të shoqërisë përmiratim;
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që e kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme sic parashikohen ne ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Raporton para asamblese të përgjithshme e shoqërisë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rendësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërise tregtare;
- Administratori do të shpërblehet sipas përcaktimit të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore te ligjit nr 9901 datë 14.04.2008.

Neni 18
Kontrolli i brendshem.

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një ekspert kontabël të regjistruar, i cili është përgjegjës përparrë shoqërisë për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës se tij.


Neni 19
Bilancet dhe te ardhurat.

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë do të mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, perveç rasteve e urdhërave të veçanta të ortakëeve të shoqërisë.

Në fund te çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël dhe rezultati ekonomik humbje/fitim. Bilanci kontabël miratohet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhës dhe pas pagimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për perdorim asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

Neni 20
Shpërberja e shoqerise.

Shpërberja e shoqërisë mund të vij në çdo kohë dhe çfardo shkaku. Në rast shkrirje para afatit të shoqërisë, Asambleja e përgjithshme e shoqërisë vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidator duke i përcaktuar dhe detyrat.



Ne rastin e likujdimit emërtimi i shoqërise do të shoqërohet nga shenimi "shoqëri në likujdim".

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 te ligjt nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit".

**Neni 21
Dispozitat përfundimtare.**


Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.

Shoqëria "**DM VLORA**" Sh.p.k. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi, normat e këtij statutit dhe të aktit themelues bashkangjitur.

Ky statut nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë në datën 15/11/2023.

ORTAKET

Genc DEROMEMAJ



Knidi-MERKAJ



ADMINISTRATORE

Faire MERKAJ

